

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2018

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË DHE BESUESHMËRIA E FAKTEVE ELEKTRONIKE NË PROCESIN E AUDITIMIT

Rexhep Hoxha

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**



Kolegji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË DHE BESUESHMËRIA E FAKTEVE
ELEKTRONIKE NË PROCESIN E AUDITIMIT**

Shkalla Bachelor

Rexhep Hoxha

Tetor, 2018

Prishtinë



Koleji UBT

Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome

Viti akademik 2012 / 2013

Rexhep Hoxha

**PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË DHE BESUESHMËRIA E FAKTEVE
ELEKTRONIKE NË PROCESIN E AUDITIMIT**

Mentor: Dr. Sc. Bukuriye Jusufi

Tetor, 2018

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Auditimi i Teknologjisë së Informacionit është shndërruar në një nga temat kryesore të auditimit që zhvillohet nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) në mbarë botën. Ky është një reagim normal ndaj operacioneve kompjuterike në zhvillim në organizatat qeveritare dhe publike. Sistemet e IT që përdoren duhet të garantojnë se ato mbrojnë të dhënat dhe asetet e biznesit të organizatës, po ashtu mbështesin misionin, qëllimet financiare dhe specifike. Ndërkohë që përdorimi i IT ka sjellë përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve, ka sjellë gjithashtu bashkë me to risqe dhe vulnerabilitete të lidhura me bazat e të dhënave të kompjuterizuara si dhe me aplikacionet e biznesit, të cilat përcaktojnë një mjedis pune të automatizuar. Roli i një auditimit IT është ofrimi i sigurisë së arsyeshme se ekzistojnë procese të përshtatshme për të menaxhuar risqet dhe vulnerabilitetet e lidhura me IT. Në auditimin e IT, mjedisi, proceset mjetet, gjithëpërfshirja dhe mënyra të tjera për të menaxhuar një funksion përcaktohen gjithashtu si kontrole. Do të shtjellojmë motivet që nxisin organizata të ndryshme që të përdorin sa më shumë sistemet e IT për auditim dhe për mbrojtjen e të dhënave kryesore të tyre. Do të tregojm arsyet se pse duhet bizneset e ndryshme sa më shpejtë të I besojn më shumë IT-s dhe të përdorin programet dhe mënyrat e ndryshme të cilat ofrohen nga IT për mbrojtjen e të dhënave dhe auditimin e bizneseve. Përdorimi i teknologjis në ditët e sotme është objektiv kyç për zhvillimin ekonomik të një vendi dhe prioritet strategjik i qeverive. Përthithja e këtyre ideve në botën e auditimit kërkon politika dhe strategji të mirëpërcaktuara, përmirësime të vazhdueshme në kuadrin ligjor dhe institucional, stabilitet dhe rritje ekonomike të qëndrueshme, përmirësim dhe modernizim të infrastrukturës si dhe përmirësime në klimën për mjedisin e biznesit dhe investimeve.

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Nuk mund të përshkruhen të gjitha ato që kanë ndodhur që kur fillova studimet Bachelor ne degën Banka Financa dhe Kontabilitet. Për rrjedhojë, do ta kufizoj vetëm me faleminderimin e disa prej shumë personave, të cilët më ndihmuan në përmbushjen e studimeve të mia, të cilëve do të doja t'u shprehja mirënjohjen time.

Një faleminderim special shkon për Mentoren time Dr. Bukurije Jusufi, për ndihmën dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës sime dhe për kontributin e saj në finalizimin e punimit tim të diplomes, produkt i shumë orëve konsultimi, këshillimi dhe mbështetjeje nga ana e saj. Faleminderit profesoresh!

Faleminderoj miqtë e mi për mbështetjen që më kanë dhënë në çdo çast.

Dëshiroj, në fund, të shpreh një mirënjohje të thellë për familjen time së cilës i detyrohem shumë për fillimin dhe finalizimin me sukses të këtij udhëtimi, sa të veshtire aq edhe të bukur.

Faleminderit të gjithëve!

PËRMBAJTJA:

LISTA E TABELAVE:	IV
FJALORI I TERMAVE	V
1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1 Teknikat e Auditimit.....	2
2.2 Teknikat e Auditimit - CAAT dhe Automatizimi i Auditimit.....	4
2.3 Përkufizimi i Teknikave të Auditimit të Asistuar nga Kompjuteri (CAAT).....	4
2.3.1 Përparësitë e auditimit që përdor CAAT-s	6
2.3.2 Përdorimet e ndryshme të CAAT-ve	7
2.4 Përdorimi i kompjuterit në menaxhimin dhe administrimin e auditimit	12
2.5 Objektivat e auditimit të IT	19
2.6 Qëllimi i auditimit të IT	20
2.7 Besueshmëria e fakteve të auditimit.....	22
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	23
4. METODOLOGJIA	26
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	28
6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	31
7. REFERENCAT	33

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1. Faktorët kyç sipas modelit konceptual mbi madhësinë e departamentit të Auditimit të Brendshëm	3
Tabela 2. Vlerësimi Camels.....	14
Tabela 3. Komponentët e riskut të biznesit dhe auditimit	24

FJALORI I TERMAVE

AAA - American Accounting Association

AICPA - American Institute of Certified Public Accountant

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

ASD - Agjensia e Sigurimit të Depozitave

BSH – Banka e Shqipëris

COSO - Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission

DPPP - Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parasë

FEI - Financial Executives International

FOLLOW UP – Procesi ndjekjes së Statutit të Rekomandimeve të Raporteve të Auditimit

IIA - Institution of Internal Auditors

IIARF - Institution of Internal Auditors Research Foundation

IMA - Association of Accountants and Financial Professionals in Business

IPPF - International Standards for the Professional Practice of Internal Auditing

ISA - International Standards of Auditing

MF - Ministria e Financave

SPSS - Statistical Package for the Social Sciences TI

SA - Standards of Auditing

SAS - Statements of Auditing Standards

SI - Siguria e Informacionit

1. HYRJE

Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit ka ndryshuar mënyrën sesi ne punojmë në shumë mënyra, ku nuk përjashtohet as auditimi. Kompjuteri gjithëpërfshirës, që është padyshim një nga mjetet më efektive të biznesit, ka sjellë gjithashtu edhe dobësi të mjedisit të automatizuar të biznesit. Çdo dobësi e re ka nevojë të identifikohet, minimizohet dhe të kontrollohet; duke vlerësuar mjaftueshmërinë e çdo kontrolli nevojiten metoda të reja auditimi. Kompjuterat janë maturuar nga të qenët vetëm sisteme procesuese të të dhënave në atë që sot ata grumbullojnë, ruajnë dhe ofrojnë akses ndaj sasive të mëdha të të dhënave. Këto të dhëna përdoren në vendimmarrje dhe në shkëmbim informacioni përgjatë rrjeteve si publikë ashtu edhe privatë. Në fakt, me ardhjen dhe rritjen e sistemeve e rrjetit kompjuterik, sistemet kompjuterike janë tashmë sisteme informacioni. Si një provë e këtij evolucioni, termi „EDP audit“ është zëvendësuar me terma të tilla si „Auditimi i Teknologjisë së Informacionit“ dhe „Auditimi i Sistemeve të Informacionit“. Me rritjen në investime dhe varësinë në sistemet kompjuterike nga subjektet e audituara, është bërë e domosdoshme për audituesin e IT të adoptojë një metodologji dhe qasje të saktë në mënyrë që të identifikojë risqet e integritetit të të dhënave, abuzimet dhe privatësinë, si dhe të garantojë siguri se ekzistojnë kontrollet e minimizimit të këtyre risqeve. Në një sistem IT, sidomos kur është i implementuar në një mjedis me kontrolle jo të sakta, subjekti i audituar ndeshet me shumë risqe, të cilat duhet të identifikohen nga audituesi i IT. Edhe kur subjekti i audituar, ka implementuar disa masa të reduktimit të risqeve, një auditues i pavarur duhet të japë garanci se kontrollet e duhura (Kontrollet e Përgjithshëm të Kompjuterave ose/dhe Kontrollet e Aplikacioneve) janë projektuar dhe operojnë për të minimizuar ekspozimin ndaj risqeve të ndryshëm.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Teknikat e Auditimit

Intervistimi Në këtë njësi studimore, vazhdojmë me shqyrtimin tonë të teknikave që ju pritët t'i zotëroni me efikasitet për të qenë në gjendje t'i përmbushni detyrat tuaja të auditimit në një mënyrë profesionale, efektive dhe efikase. Në këtë njësi, do t'i mësoni aftësitë themelore të intervistimit. Si një mjet për grumbullimin e informatave, ju duhet të jeni në gjendje t'i bëni pyetje përkatëse stafit të të audituarit, të dëgjoni me vëmendje dhe shënoni me përpikëri çka ju tregojnë ata juve dhe në një mënyrë të tillë që do ta evitonte nevojën për parashtrimin e pyetjeve pasuese shtesë.

Tabela 1. Faktorët kyç sipas modelit konceptual mbi madhësinë e departamentit të Auditimit të Brendshëm

Faktorët kyç		Shembuj
1.	Karakteristikat e kompanisë	Karakteristikat kyçe <ul style="list-style-type: none"> • Madhësia e kompanisë • Industria • Vendodhja gjeografike
2.	Karakteristikat e kompanisë dhe strukturat qeverisëse	Karakteristikat e Bordit, Komitetit të Auditimit dhe funksionit të Drejtimit të Riskut <ul style="list-style-type: none"> • Numri i anëtarëve të Komitetit të Auditimit; • Funksione të tjera që kryejnë shërbime garantuese (funksioni i Përputhshmërisë, Drejtimit të Riskut)
3.	Misioni i Auditimit të Brendshëm, siç shihet nga palët e përfshira	Aktivitetet dhe përgjegjësitë që ka misioni i Auditimit të Brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • Auditimi Operacional • Auditimi Financiar • Këshillime
4.	Vlera e Auditimit të Brendshëm	Aktivitetet që kryen Auditimi i Brendshëm dhe që normalisht i shtojnë vlerë kompanisë <ul style="list-style-type: none"> • Auditimi Operacional • Auditimi Financiar • Këshillime
5.	Rreshtimi i Auditimit të Brendshëm sipas pritshmërive të palëve të përfshira (stakeholders)	Nëse Auditimi i Brendshëm dhe palët e tjera (Stakeholders) bien dakort në rëndësinë e aktivitetëve të Auditimit të Brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • I rreshtuar • Jo i rreshtuar • Rënia dakort me rëndësinë e Auditimit të TI-së
6.	Karakteristikat e stafit të Auditimit të Brendshëm dhe strategjitë	Qasja dhe atributet e vendimeve të stafit të Auditimit të Brendshëm <ul style="list-style-type: none"> • I kontraktuar • Staf i brendshëm dhe i kontraktuar • Staf i rekrutuar rishtas • Vetëm staf me eksperiencë
7.	Cilësia e shërbimeve të Auditimit të Brendshëm	Mat nëse Auditimi i Brendshëm arrin pritshmëritë <ul style="list-style-type: none"> • Tejkalon pritshmëritë • Arrin pritshmëritë • Është nën pritshmëri

Burimi: IIAF (2010)

2.2 Teknikat e Auditimit - CAAT dhe Automatizimi i Auditimit

Në këtë njësi studimore ju do të mësoni për përdorimet ku auditori aplikon softuerët dhe kompjuterët (d.m.th. Teknologjinë Informativë, apo IT, me fjalë tjera) për t'i ndihmuar ata në kryerjen e detyrave të tyre të auditimit. Ne do të shikojmë në shtrirjen e përdorimit të sistemeve të IT-së nga auditorët për vënien në funksion të Teknikave të Auditimit të Kompjuterizuar (CAAT) për të përmirësuar efikasitetin e punës së tyre dhe për të ofruar shërbime më efektive të auditimit për menaxhmentin dhe si rezultat edhe për organizatën. Ne do të zgjerojmë analizën tonë të përdorimit të CAAT-së për të shikuar në përdorimet e përgjithshme të softuerëve pyetës në kompjuterë, duke diskutuar përparësitë dhe mangësitë e përdorimit të tij dhe si mund ta zhvillojë një projekt pyetës të bazuar në kompjuterë. Ne do të konkludojmë me një diskutim mbi përfitimet dhe mangësitë e përdorimit të kompjuterëve për automatizim të shumë prej detyrave tona të auditimit. Ju lutem vini re: Kjo njësi nuk fokusohet në fazat kyçe të përfshira në kryerjen e auditimeve speciale të bazuara në sisteme të IT-së, financiare dhe jo-financiare. Ju do të shqyrtoni këto teknika në modulën e Auditimit të Brendshëm të Avancuar si pjesë e studimeve të radhës në nivelin VSIA (Struktura COBIT 4.1., 2007).

2.3 Përkufizimi i Teknikave të Auditimit të Asistuar nga Kompjuteri (CAAT)

Në këtë kapitull ne do të përshkruajmë Teknikat e Auditimit të asistuar nga Kompjuteri (CAAT) në një nivel të përgjithshëm dhe pastaj të japim disa lloje më specifike të CAAT-ve që ju mund t'i përdorni si një auditor. Përdorimi i CAAT-ve nga një auditor përfshinë përdorimin e kompjuterit për të bërë testimin e auditimit apo për të ndihmuar auditorin të kryej procedurat e auditimit. Kjo nganjëherë përshkruhet si auditim “me kompjuter” për të dalluar atë nga përdorimi i aplikacioneve kur kryejmë një “auditim të kompjuterit”. Sa i përket përdorimit të CAAT-së nga auditori, Instituti i Auditorëve të Brendshëm thekson si në vijim në ribotimin e tetorit 2008 të Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm: “Auditorët e brendshëm duhet të kenë njohuri për rreziqet kyçe të teknologjisë informative, kontrollet dhe teknikat e auditimit teknologjik në dispozicion për

të kryer punën e tyre të ngarkuar. Megjithatë jo të gjithë auditorët e brendshëm pritet të kenë ekspertizën e një auditori të brendshëm përgjegjësia kryesore e të cilit është auditimi me teknologji informative.” Standardet gjithashtu theksojnë: “Në ushtrimin e kujdesit të duhur profesional auditorët duhet të shqyrtojnë përdorimin e auditimit të bazuar në teknologji dhe teknika tjera të analizimit të të dhënave.” Standardet më tej përkufizojnë teknikat e auditimit të bazuar në teknologji si “Ndonjë mjet i automatizuar i auditimit, siç janë softuerët e gjeneralizuar të auditimit, gjeneruesit e testimit të të dhënave, programet e kompjuterizuara të auditimit, mjetet e specializuara të auditimit, dhe teknikat e auditimit të ndihmuara me kompjuterë” Nga kjo ju mund të shihni se auditorët modern, të trajnuar mirë dhe të pajisur mirë duhet të shqyrtojnë përdorimin e IT-së, d.m.th. CAAT, për t’i ndihmuar ata në mbledhjen dhe analizimin e dëshmive nga sistemet e mëdha dhe nganjëherë komplekse. (IT., 2007) Në këtë fazë, një vërejtje: Duhet të jeni plotësisht në dijeni për dallimin ndërmjet përdorimit të CAAT-së të pastër, ku auditori përdor kompjuterin për të krijuar apo ndihmuar në krijimin e dëshmive të auditimit dhe automatizim të auditimit, ku auditori përdor kompjuterin për automatizim të detyrave të caktuara të përsëritura në fazën e planifikimit, punës në terren, shqyrtimit, raportimit. Derisa pa dyshim një mjet shumë i fuqishëm në administrimin e ciklit të auditimit, si auditorë ne duhet të fokusojmë vëmendjen tonë kryesisht në aktivizimin e asaj fuqie të procedimit për qëllim të përmirësimit të metodikës dhe teknikave tona të auditimit dhe jo thjesht në aftësinë e kompjuterit për të ofruar procedim të fjalëve apo lehtësim të punës në lista për të shpejtuar auditimin. Aftësitë tuaja si auditor do të demonstrohen se si i shfrytëzoni në mënyrë produktive pajisjet dhe njohuritë tuaja të IT-së, për të përmirësuar cilësinë e dëshmive të mbledhura dhe interpretimet në të cilat arrini duke përdorur ato. Ne do të kthehemi te diskutimi i këtij dallimi të rëndësishëm në kapitullin e fundit të kësaj njësie studimore.

Tri kategoritë kryesore të CAAT-ve

Për momentin ne do të përqendrohemi në CAAT-të në kuptimin e parë. Janë tri kategoritë kryesore të këtyre llojeve të CAAT-ve:

1. CAAT-të e testimit të të dhënave: Auditori përdor softuer special pyetësor auditues për shqyrtim dhe testim të përmbajtjes së dosjeve të të dhënave të cilat formojnë një pjesë të

sistemit të aplikacionit nën shqyrtim të auditimit. Kjo identifikon të dhënat e gabuara dhe gjithashtu i siguron informata menaxhmentit.

2. CAAT-të e testimit të sistemit: Auditori proceson të dhëna të testimit të auditimit të përgatitura në mënyrë të veçantë përmes një sistemi të aplikimit për testimin e operacioneve të tij (përshembull llogaritjet e tij) dhe kontrollet e tij.

3. CAAT-të analitike dhe mbështetëse: Përdoret softuer i veçantë për analizim të informatave nga auditori, d.m.th. informata që jo domosdoshmërisht prodhohen nga kompjuteri. Shembujt përfshijnë analizat e regresit dhe shqyrtimin analitik të të dhënave historike financiare për analiza të trendit.

Softueri po-ashtu mund të përdoret për mbështetje të aktivitetit të auditorit, p.sh. gjenerimin e numrave të rastësishëm me kompjuter për t'i nxjerr mostrat me dorë. (Nëse kompjuteri gjithashtu bën nxjerrjen e mostrave, kjo njihet si testim CAAT i të dhënave). Ky kapitull do të fokusohet në CAAT-të e testimit të të dhënave dhe testimit të sistemit. (IT., 2007)

2.3.1 Përparësitë e auditimit që përdor CAAT-s

Para se të vazhdojmë me diskutimin e përfitimeve që sjell CAAT-ja në botën e auditimit, le të shohim nëse ju mund të mendoni për disa që janë për juve. CAAT-s kundrejt testimit manual të auditimit CAAT-të ofrojnë ca përparësi krahasuar me testimin manual të auditimit në raste të caktuara:

1. Rritja e shtrirjes së testimit të auditimit: Shpejtësia dhe saktësia me të cilën kompjuteri mund të procesojë vëllime të mëdha informatash i mundëson auditorit ta rrisë me të madhe shtrirjen e verifikimit të auditimit; që shpesh mundëson 100% mbulim të sistemeve të caktuara. Kjo mund të reduktojë apo edhe ta eliminojë rrezikun e mostrimit për rritje minimale në koston e auditimit. Për shembull, mund të mos marrë fare apo vetëm pak kohë për një kompjuter të ri-llogaris të gjitha variacionet e çmimeve në dosje të stoqeve sesa të nxirren e kontrollohen mostrat e llogaritjeve. Kostoja në kuptimin e kohës shtesë të përfshirë në auditim (apo kostoja e mundshme e angazhimit të atij auditori në një detyrë tjetër) mund të numërohet në minuta duke pasur fuqinë e procedimit të laptopëve sot, dhe për më tepër japin përfitime në aspektin e rekomandimeve potenciale të bëra që mund të kursejnë disa mijëra euro të organizatës.

2. Kryerja manuale e detyrave të pamundura: Në disa sisteme kompjuterësh (në veçanti në rrjete shumë të sofistikuara dhe të mëdha apo të gjera) mund të mos ketë fare gjurmë të dukshme të auditimit. Opsioni i vetëm i mundshëm për auditorin në raste të tilla mund të jetë të përdor kompjuterin për të gjurmuar nëpër sistem për të verifikuar operimin korrekt të kontrolleve dhe proceseve kyçe. Kjo sigurisht mund të kërkojë njohuri të hollësishme të sistemit në pjesën e auditorit në veçanti nëse sistemi është kompleks dhe mund të konsiderohet të kufizojë në auditimin e sistemeve IT. Megjithatë, ekzistojnë pako softueri që mund të përdoren nga auditorët e përgjithshëm për tu mundësuar atyre të përcjellin transaksionet përmes sistemeve krahasimisht të sofistikuara pa angazhuar në shkallë të plotë auditimin IT.

3. Efektshmëria e kostos: CAAT mund të jetë një metodë me kosto efektive e të arriturit të objektivave të një auditimi në krahasim me koston e procedurave alternative manuale. Efektshmëria e koston rritet ku ka mundësi për ripërdorim, psh. në vitet vijuese apo në sisteme, ose organizata të ndryshme. Kjo kryesisht për shkak të koston së CAAT-së, që zakonisht vendoset në koston e zhvillimit.

4. Eliminimi i përsëritjes së punëve: Përdorimi i kompjuterit për të kryer detyra të përsëritshme dhe të mërzitshme (siç është përzgjedhja e mostrave) e liron auditorin të përqendrohet në aspekte të rëndësishme për gjykim të auditimit. Mbani mend roli i juaj si një auditor i brendshëm është të kryeni shërbime për organizatën që u punëson juve; një pjesë e atij roli është dhënia e këshillave menaxhmentit. Sa më shumë kohë që kaloni në diskutimin e këshillave që mund të jepni, më tepër se sa në mbledhjen e dëshmive me të cilat ju përfundimisht e formoni opinionin tuaj, aq më efektiv (dhe efikas) jeni në punën tuaj. (IT., 2007)

2.3.2 Përdorimet e ndryshme të CAAT-ve

Në këtë kapitull ju do të mësoni në lidhje me kategori të ndryshme të softuerëve që mund të përdoren nga auditori. Përparësitë dhe mangësitë e secilës do të diskutohen. Ne do të shtjellojmë përdorimin e pakove hetuese të bazuara në kompjuter dhe paraqesim fazat e

ndryshme të projektit hetues të bazuara në kompjuter (Paul, Anand, Iyer, & Sudha, 2012). Kategoritë alternative të softuerëve Ekziston një numër i llojeve të ndryshme të softuerëve CAAT në dispozicion. Kategoritë kryesore janë si në vijim:

- Simulimi paralel

Kjo teknikë i mundëson auditorit të riprodhojë rezultate të procedimit dhe llogaritjes duke përdorur të dhëna apo transaksione të drejtpërdrejta dhe programin e vetë auditorit për krahasim me rezultatet e nxjerra nga sistemi i audituar.

- Modulet e ngulitura të auditimit

Modulet e ngulitura të auditimit (gjithashtu të njohura si softuerë rezidente të auditimit) kërkojnë kodin e programit të auditorit për tu ngulitur në softuer. Kur është në përdorim ai ekzaminon transaksionet menjëherë kur të jenë proceduar nga sistemi për të parë nëse janë në përshatje me kriteret e përzgjedhjes. Përdorimet kryesore të kësaj teknike janë për dosje shumë të mëdha apo sisteme të kohës së vërtetë si metodë e mostrimit apo e përzgjedhjes së transaksioneve. (Paul, Anand, Iyer, & Sudha, 2012)

- Shqyrtimi i programit

Shqyrtimi i programit përbëhet nga ekzaminimi i listimeve të kodeve burimore të programeve për të përcaktuar mënyrën në të cilën ekzekutohet programi. Një auditor i kualifikuar mund të nxjerrë konkluzione në lidhje me efektivitetin e aplikimit të programit përmes shqyrtimit të kodit burimor. Kjo është teknikë e specializuar që kërkon aftësi të posaçme të programimit por është e dobishme për të verifikuar saktësinë e kontrolleve të procedimit të përshkruara në program dhe për të verifikuar zbatimin e standardeve të programimit të organizatës.

- Krahasimi i programit

Softueri i specializuar për krahasim mund të përdoret për krahasim të dy versioneve të ndara të ndonjë dosje me qëllim të identifikimit të dallimeve. Auditorët mund të krahasojnë kopjet e programeve dhe kontrollojnë nëse ndryshimet janë operuar me korrektësi apo se nuk janë bërë ndryshime të paautorizuara. Çfarëdo përjashtimi apo ndryshimi i paautorizuar do të ketë nevojë për hetim auditimi. (IT., 2007) Derisa kjo teknikë është e dobishme në, për shembull parandalimin e mashtrimit, softueri mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe si i tillë ka të ngjarë të përdoret vetëm në organizata shumë të mëdha. Për më tepër për koston, kjo teknikë kërkon

njohuri të veçanta të gjuhëve programuese me qëllim të ndjekjes së rëndësisë së ndonjë ndryshimi të bërë në program.

- Softueri i rikthimit të të dhënave

Ky me siguri është CAAT-i i përdorur më së shumti. Mund të përdoret për nxjerrjen dhe manipulimin e të dhënave të kompjuterizuara, për testimin e të dhënave dhe për formatimin e raporteve për auditim dhe qëllime të raportimit. Gjithashtu mund të përdoret për testim të mënyrës se si procedurat e programuara dhe kontrollet kanë funksionuar në të dhënat e proceduara.

Softueri i rikthimit të të dhënave më së shumti përdoret për ekzaminim apo testim të transaksioneve në një sistem kompjuteri duke: Përzgjedhur transaksione mostër Kur përzgjidhet një mostër transaksioni për testim apo shqyrtim auditimi, mund të përzgjidhen të dhënat:

- nga mostra të rastit, për shembull për të ofruar oraret e testimit substancial për auditorët e jashtëm.
- nga transaksionet 'të tërhequra' nga sistemi i drejtpërdrejt kompjuterik për testimin e auditimit të një natyre të veçantë me qëllim të testimit të kontrolleve. Për shembull, një CAAT do të mund të jepte një listë të të gjitha transaksioneve për një madhësi të caktuar, apo ato që kanë qenë të pakryera për një kohë të caktuar. (IT., 2007)

Ri-performimi i llogaritjeve

Gjurmët e auditimit shpesh humben apo turbullohen nga detyra të shumëfishta dhe llogaritje që bëhen nga sistemi kompjuterik, ku rezultat përfundimtar është përmbledhja. CAAT-të mund të përdoren për të -ri-performuar përmbledhjet duke përzgjedhur dhe shtypur hollësitë e transaksioneve individuale dhe pastaj llogaritjet ri-performuese ku paraqitet bërja e llogaritjes.

Shtresimi apo ekzaminimi i fushëveprimit të një popullacioni

Të dhënat mund të kategorizohen dhe ndahen për ta rritë dobinë e testimit të auditimit. Për shembull transaksionet nga grup i veçantë i kodeve të kostos mund të nxirren si pjesë e shqyrtimit të sistemeve të kësaj fushe, apo mundësisht pagesat e kryera nga individ i caktuar do të mund të zgjidheshin si pjesë e një hetimi të auditimit.

Përputhja e të dhënave

Përputhja e të dhënave në faturat që krahasojnë pako të dhënash të një organi kundër regjistrimeve tjera të bëra nga organi i njëjtë apo ndonjë tjetër për të parë se sa përputhen ato. Kjo mundëson identifikimin e pagesave dhe kërkesave mashtruese. Përputhja e të dhënave në veçanti është e përdorshme ku ka rrezikshmëri të madhe të pagesave mashtruese, siç është strehimi apo përfitime tjera sociale. Teknikat e sofistikuara në rritje janë duke u zhvilluar për testim të dyfishimit të regjistrimeve ku ka në dispozicion vetëm informata të pjeshme. Për shembull, testet mund të kryhen për pagesat e dërguara tek adresë e caktuar postare, për të përcaktuar punë të shumëfishtë (apo një person që përdor varietete emrash) e kështu me radhë. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, , 2013) Auditori mund të shfrytëzojë edhe veçori të cilat janë të përbashkëta për rikthim të të dhënave të specializuara dhe pako hetuese, për kryerje të detyrave në vijim:

- Mostrimi i veçorive.
- Testimi i dyfishimit.
- Krahasimi i dosjes dhe regjistrimeve.
- Mostrimi statistikor.
- Mbledhja totale.
- Numërimi.
- Përmbledhja.
- Raportimi.

CAAT-të mund të përdoren për kontrollimin e rezultateve të procedimit për testim të dështimeve në kontroll. Për shembull, kompjuteri mund të hetohet për dhënien e informatave substanciale të auditimit për transaksionet e refuzuara dhe arsyen se pse ato refuzohen. Kjo mund të jetë e dobishme për informim të të angazhuarve në vlerësim të kontrollit të auditimit.

- Kontrollimi i hyrjeve në sistem

Hetimi i hyrjeve/kyçjeve në sistem (dhe dosjet e kyçjeve) për përjashtime dhe gabime, siç janë tentimet për qasje të paautorizuar, ndihmon sigurinë e kompjuterit dhe jep informata për përdorimin e makinës dhe për kontrollin e qasjeve. Këto mund të jenë të dobishme si dëshmi e aplikimit të duhur të kontrolleve të përgjithshme të kompjuterizuara siç janë, numri i

aktivizimeve të programit, regjistrimi i qasjeve në dosje të caktuara të dhënash (dosja e të dhënave të rëndësishme për shembull) dhe shkeljet e sigurisë.

Hetimi auditues bazuar në kompjuter

Zhvillimi i përdorimit të gjerë të kompjuterëve desktop dhe shumë laptopëve mobil e të fuqishëm për përdorim në punën në terren, ka sjellë deri te krijimi i qasjeve fleksibile për hetim të auditimit. Të gjitha sistemet e kompjuterizuara mund të transferojnë të dhëna për t'u analizuar dhe vlerësuar, tek dhe prej kompjuterit desktop apo laptop me lehtësi relative. Shumë auditorë tani shfrytëzojnë përparësinë e kësaj duke shkarkuar të dhëna nga kompjuterët e organizatës në kompjuterët e tyre në të cilët ata kanë instaluar një pako të hetimit auditues. (Moduli "Bazat e auditimit të brendshëm", 2011/2012) Kjo efektivisht nënkupton që ata mund të përdorin pako të njëjtë hetimi me çfarëdo lloj kompjuteri, kështu që ata mund të ndërtojnë ekspertizën dhe përvojën e tyre të një apo dy programeve të hetimit më parë sesa të kenë njohuri në pjesë të vogla nga disa të ndryshme. Mendoni për menaxherin tuaj për një moment, balancimi i shumë kërkesave që janë bërë me buxhetin e shërbimit të auditimit. Nëse aftësoheni në përdorimin e një pakoje softuerike të auditimit duhet të ketë përparësi të qarta, në aspektin e burimeve të shërbimit të auditimit që dalin nga trajnimi juaj dhe kostoja e mbështetjes së mëtejme pasi që ju duhet të jeni në gjendje të kryeni detyrat tuaja në mënyrë më efektive dhe efikase. Çmimi i softuerit me të cilin do të rritet ekspertiza juaj është i vogël në krahasim me vlerën e përmirësimeve në efikasitet dhe efektivitet të cilat janë të mundshme. Ekzistojnë disa pako të hetimit të bazuar në kompjuter, por më të njohurat janë dy pakot kanadeze, njohur si ACL (Gjuha e Komandimit të Auditimit-GJKA) dhe IDEA (Nxjerrje dhe Analiza e të Dhënave Interaktive-NADI).

Fazat e përfshira në një projekt hetues të bazuar në kompjuter.

Tani do të shqyrtojmë fazat me të cilat një auditor do të kryejë hetimin e dosjes duke përdorur kompjuterin.

1. Identifikimi: kërkesa e parë është të identifikohet dosja e të dhënave për t'u hetuar. Kjo kërkon një shkallë të të kuptuarit të sistemit. Ku është dosja? Në çfarë formati është ajo? A nevojitet shndërrim para se mund të punoni në të?
2. Përzgjedhja: Në raste të dosjeve shumë të mëdhamund të jetë e nevojshme të eliminohen shënime apo pjesë të shënimeve që janë pa interes për auditorin në mënyrë që të ruhet

hapësirë e nevojshme në memorien-hard disqet e Kompjuterëve dhe të minimizohet koha e transferimit dhe procesimit. Kjo mund të përfshijë përdorimin e softuerëve në kompjuterin kryesor.

3. Shkarkimi: Të dhënat transferohen fizikisht nga kompjuteri kryesor tek hard disku i kompjuterit të auditorit. Varësisht nga burimi dhe madhësia e dosjeve, kjo mund të përfshijë kopjimin e thjeshtë në disketa apo ndonjë formë të sistemit të komunikimit apo përdorimin e CD-ROM-it i integruar në kompjuter. (IT., 2007)

4. Konvertimi dhe definimi: Prapë, varësisht nga burimi, të dhënat mund të nevojitet të konvertohen në format të PC-së. Pakot kryesore hetuese përfshijnë pajisje për identifikimin dhe konvertimin e të gjitha regjistrimeve të përbashkëta të formateve që gjenden në kornizën kryesore dhe në minikompjuterë. Duke pasur parasysh që këto pako janë krejtësisht të pavarura nga sistemi që auditohet, ata duhet të informohen për shënimet dhe strukturën e dosjeve të të dhënave para se ata mund të shfrytëzojnë ato në mënyrën e duhur. Për disa pako të caktuara kompjuterike të kontabilitetit që përdoren zakonisht, definimi i fushave dhe shënimeve vijnë së bashku me softuerin e hetimit. Në disa sisteme të bazave të të dhënave kompjuterike, definimi i të dhënave ndërtohet në dosjet e të dhënave dhe mund të interpretohen drejtpërdrejt nga softueri hetues. Por nëse sistemi që auditohet është unik apo është pako më e paqartë, ju duhet të jepni definicionet vetë. Ju duhet të jeni në gjendje të siguroni faqosjet e shënimeve nga departamenti i kompjuterëve. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, , 2013)

5. Procesimi dhe rezultatet: Të dhënat tani mund të hetohen dhe rezultatet të nxirren. Procedurat precize që duhet ndërmarrë varen nga zgjedhja e auditorit për teknikat e duhura dhe softueri në dispozicion për kryerje të detyrës

2.4 Përdorimi i kompjuterit në menaxhimin dhe administrimin e auditimit

Në këtë kapitull do të diskutojmë përdorimin e kompjuterëve në planifikimin, dokumentimin dhe kontrollimin e një auditimi, dhe gjithashtu në raportimin e rezultateve të auditimit. Në paragrafët hyrës të kapitullit të parë të kësaj njësie studimore ne kemi thënë se do të kthehemi

tek diskutimi në lidhje me dallimet e rëndësishme ndërmjet CAATsë dhe automatizimit të auditimit. Në pjesët paraprahe, ne kemi shikuar në mënyrat në të cilat auditori mund të lidhë fuqinë e procesimit të mundësive të sofistikuara analitike të pakove softuerike moderne të auditimit për të bërë përpjekjet tona të auditimit më produktive, efikase dhe të kënaqshme për personin. Në këtë kapitull përfundues ne do të shtjellojmë një mënyrë tjetër në të cilën auditorët mund të lidhin përfitimet e IT-së – përdorimin e kompjuterëve në menaxhimin e auditimit.

Ne do të shqyrtojmë këtë temë nën tre tituj:

1. Planifikimi i auditimit.
2. Dokumentet punuese dhe kompjuteri.
3. Kontrolli i auditimit.

Ju duhet të vëreni se informatat në pjesët e planifikimit të auditimit ndërlidhen kryesisht me auditimin e brendshëm. Informatat në dy pjesët tjera zbatohen në mënyrë të njëjtë për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. (Paul, Anand, Iyer, & Sudha, 2012)

Planifikimi i auditimit

Planifikimi i auditimit, siç e kemi mësuar në njësitë paraprahe, është themelor për të qenë në gjendje për të kryer në mënyrë të suksesshme një auditim. Megjithatë, siç e dini kryerja e vlerësimit fillestar për të qenë në gjendje për të kryer tri llojet kryesore të planifikimit të auditimit (strategjik, operacional dhe taktik / angazhimi) është edhe komplekse edhemerrshumë kohë .Në shumë vende,shumë organizata të shërbimeve publike kanë zhvilluar pakot e tyre të planifikimit të auditimit të kompjuterizuar derisa tjerat kanë blerë pako të përdorura të zhvilluara nga organizatat komerciale që specializojnë në disenjiimin dhe programimin e sistemeve kompjuterike.

Tabela 2. Vlerësimi Camels

Vlerësimi Camels

Vlerësimi		Niveli i riskut
CAMELS	Cilësia e aktivitetit	
1	E fortë	I ulët
2	E kënaqshme	I pranueshëm
3	Mesatare	Mesatar
4	E dobët	I konsiderueshëm
5	Keq	I plotë / lartë

Burimi: Banka e Shqipërisë

Cilëndo pako që përdor shërbimi i auditimit, ajo i mundëson menaxhmentit të auditimit të:

1. Përcaktojnë nevojën e përgjithshme të auditimit dhe shpeshësinë e fushëveprimin e shqyrtimit. Në veçanti, pasi që formulat e treguesve të rrezikut kryesisht nxirren nga formula matematikore kompjuterë mund të ndihmojnë në llogaritjet e vlerësimit të rrezikut që marrin shumë kohë. (Brisebois et al, n.d.)

2. Mirëmbajnë planet e auditimit në model të përdorshëm (kjo gjithashtu vlen për auditimin e jashtëm). 3. Monitorojnë objektivat dhe kohën e angazhimit në auditim dhe shqyrtimin e performancës së auditimit (kjo gjithashtu vlen për auditimin e jashtëm). 4. Prodhojnë informata të kushtueshme për ndarjen e kohës së auditimit për qendrën operative përkatëse e cila është audituar apo për të analizuar performancën e auditimit si pjesë e shqyrtimit të cilësisë apo iniciativës së përmirësimit të efikasitetit (kjo gjithashtu vlen për auditimin e jashtëm).

Përdorimi i kompjuterëve për përpilimin e dokumenteve të punës

Rritja e përdorimit të kompjuterëve desktop dhe laptopëve në auditim ka rezultuar në rritje të efikasitetit dhe efektivitetit të auditimit. Ne do të shikojmë në disa prej përdorimeve për të cilat janë vënë në punë mikro-kompjuterë. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, , 2013) Auditorët gjithmonë kanë punuar në Word Processing, por në të kaluarën ka qenë me laps dhe letër për analizim. Kjo shpesh ka rezultuar në mal me letra të shkruara, rishkruara, dhe mbishkruara, ku një sasi e madhe prej së cilës ka përfunduar si mbeturinë në shportë. Mundësia për të punuar në Word Processing u mundëson auditorëve të shkruajnë, riorganizojnë dhe përmirësojnë komentet dhe raportet e auditimit më shpejt dhe në mënyrë

më precize sesa më parë. Pakot e Word-it mundësojnë edhe prodhimin e dokumenteve të standardizuara – që do të përdoren nga anëtar të shërbimit të auditimit si pjesë e stilit të tyre të brendshëm dhe për prezantimin e raporteve në mënyrën e preferuar dhe njohur për organizatën të cilës auditori i brendshëm i kryen shërbime. Diagramet gjithashtu përfitojnë nga përdorimi i kompjuterëve. Në të kaluarën diagrami ka qenë rezultati i aplikimit të lapsit dhe shablloneve në letër të formatit të madh. Grafikonet vizatoheshin e ri-vizatoheshin, një proces ky i lodhshëm e shpenzues kohe. Madje edhe kur konsiderohej si i përfunduar, mund të kërkohet futja e informatave e shënimeve të reja sugjeruar nga rishikuesit. Edhe nëse diagrami kishte paraqitursaktësisht kushtet në kohën e auditimit të tanishëm, ato do të mund të jenë vjetruar për kohën e shqyrtimit të ardhshëm. Sot kemi në dispozicion softuerin i cili i lejon auditorit që të përpilojë dhe ndryshojë diagramet me lehtësi. Kur të jetë kryer, diagrami mund të ruhet në formë elektronike për t'u rishikuar dhe përditësuar me lehtësi (me kusht që auditori të kryej procedurat e mbledhjes së dëshmive dhe testeve korrekte përgjatë punës sipas nevojës) gjatë shqyrtimit të radhës. Auditorët kanë përdorur fletë me katror për rreshtat dhe kolonat e tyre të organizuara për shifra prej që është shpikur letra. Faqet elektronike në Excel tani e bëjnë këtë në mënyrë intuitive por shumë më shpejt. Kjo mundëson krijimin e formulës një herë për të bërë llogaritje matematikore dhe analiza statistikore dhe siguron mbledhjen e saktë të shumave dhe numrave me totalit e tyre, gjithmonë nëse auditori ka futur formulën korrekte dhe ka kontrolluar integritetin e përgjithshëm të ndërtimit të këtyre faqeve. Bazat e të dhënave kanë bërë një ndikim të madh në punën e auditimit. Auditorët mund të shfrytëzojnë baza të mëdha dhe të sofistikuara të të dhënave për mbledhje dhe analizim të hollësive përkatëse në shumë mënyra. Kjo i liron auditorët nga mbledhja e lodhshme e fakteve dhe shifrave me dorë dhe u jep atyre kohë të vlefshme për vlerësim intelektual të të dhënave të mbledhura.

Megjithatë, si auditor ju duhet të aplikoni skepticizmin tuaj profesional e të shëndoshë për përdorimin e kompjuterëve desktop dhe laptopëve pasi që auditimi me to nuk është edhe pa vështirësi. Këtu janë disa për të cilat duhet të jeni në dijeni: (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, 2011/2012)

- Shumë auditor mbajnë faqet e tyre Excel, bazat e të dhënave, nxjerrin komanda, dhe dokumente në Word në pajisje të memories së jashtme të të dhënave (p.sh. USB memoriet

dhe CD-të). Sasi të mëdha të dhënave mund të mbahen në një hapësirë të vogël fizike. Rreziqet i shoqërojnë këto përfitime të dukshme. Mjetet e tilla për ruajtje të të dhënave rrezikohen nga dëmtimi dhe humbja, dhe të gjitha të dhënat e mbledhura me mund, mund të humben përgjithmonë.

- Informatat që dikur kanë qenë në dispozicion vetëm në sasi të mëdha letre që ishin shumë të dukshme tani mund të hiqen për habi në një xhep palltoje me pajisje të tilla memorike. Përveç kësaj informatat mund të ndryshohen (me pakujdesi bëhen gabime) shpesh pa ndonjë gjurmë të ndryshimit që është bërë.

- Duhet të përshtaten konventat standarde të emërtimit të fajlave për të siguruar qasjen në informata për ata që janë të autorizuar për përdorim të tyre. Pa konventat për emërtimin standard të dosjeve, mund të shpenzohen orë të tëra duke kërkuar në dosje veç e veç për ta gjetur atë që na nevojitet, e që nuk është një përdorim efektiv i burimeve të shtrenjta të auditimit.

- Të dhënat elektronike lehtë mund të humben dhe kjo mund të jetë katastrofale nëse mbetet vetëm një version i dosjeve. Prandaj është kritike që kopjet e dosjeve që mbajnë letrat e punës të ri-ruhen për çdo mbrëmje. Pasi të jetë kryer puna në terren, informatat duhet të ruhen (back up) çdo javë derisa të kryhen shqyrtimet e dokumenteve punuese dhe të jenë shkruar në mënyrën e duhur. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, 2011/2012)

- Dokumentet e punës elektronike mund të paraqesin problem nëse shqyrtuesi nuk ka kompjuter në të cilin mund të kryejë shqyrtimin. Mund të merret parasysh edhe opsioni i të shkruarit me dorë të shënimeve shqyrtuese. Megjithatë disa shqyrtues, të nxitur nga aftësitë e tyre për bërjen e ndryshimeve elektronike në letrat punuese vetë, mund të fusin komente dhe pyetje që mund të jenë të vështira për auditorin që kryen punën për të identifikuar dhe të vepronjë me to. Fatmirësisht, pakot moderne të Word-it kanë version të sofistikuar të veçorive të kontrollit që i mundësojnë auditorit dhe shqyrtuesit të identifikojnë versionet origjinale dhe të shqyrtuara dhe pikat dhe komentet dhe pyetjet me të cilën lidhen. Megjithatë të gjithë anëtarët e ekipit auditues duhet të trajnohen mirë në përdorimin e softuerëve të tillë dhe të përshtatin një qasje standarde për kryerjen e procesit të shqyrtimit duke përdorur dokumente elektronike të punës. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, 2011/2012)

Kontrolli i auditimit

Kompjuterët mund të japin ndihmesë të madhe në kontrollimin e punës audituese për shkak të logjikës së operimit të tyre dhe aftësisë për të strukturuar qasjen e një auditori për punën e tij/saj që e kryen. Normalisht të gjitha auditimet janë të caktuara me kode unike identifikuese dhe themelohen në bazë të dhënave që përmban informatat për të gjitha auditimet e koduara duke ndërlidhur gjërat e tilla siç janë data e auditimit të fundit dhe numrat e përhershëm të dosjeve. Në një sistem të tillë, oraret zakonisht plotësohen nga stafi i auditimit në baza javore apo mujore dhe aktiviteti auditues kodohet me kod(e) përkatëse të ruajtur në bazën e të dhënave. Informatat nga oraret e individëve pastaj futen si të dhëna në sistem dhe prodhohen raporte të ndryshme dhe më pas analizohen nga menaxhmenti i auditimit. Këto analiza japin informatat bazë për menaxhmentin e auditimit për të kontrolluar dhe monitoruar funksionimin e auditimit dhe për vlerësim të performancës. (IT., 2007).

Raportimi dhe Monitorimi

Mundësia e ofruar e Word-it nga IT ka transformuar aftësinë e auditorëve dhe të tjerëve të përpilojnë, ndryshojnë dhe zhvillojnë raportet e tyre. Kjo nënkupton që auditorët mund të përpilojnë raporte në baza të vazhdueshme dhe ndihmojnë në shkurtrimin e proceseve të ndryshme manuale të përpilimit dhe kohës së shpenzuar për gabimet e përfshira. Raportet e përpiluara në këtë formë duhet të jenë më në kohë dhe më cilësore pasi që auditorët të kenë marrë njohuritë përkatëse në përdorimin e Word-it dhe softuerëve tjerë. Prezantimi i raporteve, duke përfshirë përdorimin e tabelave, diagrameve etj. gjithashtu mund të ndihmojë në krijimin e përshtypjes së favorshme të një auditimi dhe kështu të rrisë vëmendjen e një menaxheri të lartë. Përdorimi i formularëve standard me logon e shërbimit gjithashtu mund të ndihmojë në shpërndarjen e stilit të brendshëm dhe i shtohet përshtypjes së një auditori profesionist. Megjithatë, cilësia e përmbajtjes së raportit ende bazohet në cilësinë e ekipit auditues dhe raport-shkruesit, kështu që ka limite në këtë përfitim. Përpilimi i raporteve vjetore për Njësinë e Harmonizimit Qendror të Auditimit të Brendshëm nga Kryesuesit e Auditimit të Brendshëm do të lehtësohet me përdorimin e raporteve përmbledhëse të auditimit dhe mundësia për nxjerrje të pikave, çështjeve dhe rasteve studimore kryesore. Auditorët e brendshëm duhet të komunikojnë në mënyra tjera pos shkrimit formal të raporteve dhe do të ketë raste kur një prezantim është mjeti më i përdorshëm i komunikimit.

Kjo mund të bëhet përmes prezantimeve të kompjuterizuara të slajdeve, për shembull kur ka nevojë për komunikim me një grup menaxherësh apo palë tjera me interes. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, , 2013)

Shembujt mund të përfshijnë:

- Prezantimin e draft planeve strategjike brenda ndonjë ministrie apo qendre buxhetore për diskutim para finalizimit.
- Prezantimin e një draft-programi të konsultimit për studimin e vlerës për para për t’u diskutuar.
- Një skicë të raportit të performancës së auditimit për diskutim.
- Një prezantim të progresit të auditimit p.sh. një raport vjetor për Njësinë Qendrore të Harmonizimit dhe Ministrisë.
- Një seancë e trajnimit të brendshëm.
- Sigurimi i cilësisë dhe punëtori tjera.
- Një prezantim të zhvillimit të një auditimi në një audiencë të gjerë.

Këto prezantime mund të avancohen shumë nga një prezantim profesionist i IT-së dhe ndihmon në ndërtimin e reputacionit dhe qëndrimit të auditimit si dhe ndihmon në komunikimin me palët me interes të cilat duhet të vendosin se çfarë vendimesh duhet marrë për rezultatet e auditimit.

Një auditim nuk përfundon me dorëzimin e një raporti. Duhet të ketë një sistem adekuat monitorimi. Kjo do të mund të ishte në një formë të një liste të thjeshtë Excel në të cilën regjistrohen rekomandimet kyçe nga raportet individuale. Një listë e tillë ofron një përmbledhje të përshtatshme për përdorim nga i tërë stafi dhe menaxherët e auditimit në punën e tyre përcjellëse. Kjo listë gjithashtu mund të përdoret për përfshirje të përmirësimeve të vlerës së shtuar aktuale dhe potenciale në raportimet audituese vjetore. Lista ofron një histori të vazhdueshme dhe hollësitë vetëm ruhen apo arkivohen kur të jenë punuar plotësisht dhe të kuptohen përfitimet. (Paul, Anand, Iyer, & Sudha, 2012)

Çfarë është auditimi i IT?

Ndërkohë që nuk ka asnjë përcaktim unik të auditimit të Teknologjisë së Informacionit, Ron Weber e ka përkufizuar auditimin e IT, si procesin e grumbullimit dhe vlerësimit të gjetjeve

për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, mirëmban integritetin e të dhënave, lejon arritjen e objektivave të përgjithshëm të organizatës dhe nëse përdor burimet në mënyrë eficiente. Me fjalë të tjera, auditimi i IT është një ekzaminim i implementimit të sistemeve të IT për tu siguruar se ato mbështesin nevojat e biznesit pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të biznesit. Mandati për auditimin e IT Mandati i SAI për të udhëhequr auditimin e sistemeve të IT përshkruhet në ISSAI 1-Deklarata e Limës. Më tej, mandati i një SAI për auditimin e IT rrjedh nga mandati i përgjithshëm i përcjellë nga SAI për të udhëhequr auditimin financiar, të përputhshmërisë, të performancës ose një kombinim të tyre. Disa SAI gjithashtu mund të kenë mandat specifik për ndërmarrjen e auditimit të IT. Për shembull, nëse SAI ka një mandat për të audituar funksionet e të ardhurave nga taksat, SAI duhet të auditorë pjesën e automatizuar të funksionit të hyrjeve nga taksat nëpërmjet derivimit nga mandati i tyre origjinal. (IT., 2007)

2.5 Objektivat e auditimit të IT

Objektivat e auditimit të IT janë të sigurojnë se burimet e IT lejojnë qëllimet e organizatës të arrihen efektivisht dhe përdorimin në mënyrë eficientë të këtyre burimeve. Auditimet e IT mund të mbulojnë sistemet ERP, sistemet IS, prokurimin e zgjidhjeve të biznesit, zhvillimet e sistemeve, vazhdimësinë e sistemeve që janë fushë specifike e implementimit të IS ose mund të jenë për të vëzhguar pjesën e vlerës që sistemet IS kanë përmbushur. Disa shembuj të objektivave të IT janë:

- Rishikim i kontrolleve të sistemeve të IT për tu siguruar mbi mjaftueshmërinë dhe efektivitetin e tyre;
- Vlerësimin e proceseve të përfshira në operacionet e një fushe të caktuar si sistemi i pagesës, sistemi kontabël;
- Vlerësimi i performancës të një sistemi dhe i sigurisë së tij, për shembull, sistemi i rezervimit të trenit;
- Ekzaminimi i procesit të zhvillimit të sistemit dhe të procedurave.

2.6 Qëllimi i auditimit të IT

Përgjithësisht SAI-t kryejnë auditimin e IT njëkohësisht me auditimin e pasqyrave financiare, rishikimin e kontrolleve të brendshme, si auditim performance të sistemeve të IT ose të aplikimeve të IT. Në terma më të përgjithshëm, auditimet e IT shtrihen në auditimet financiare (për të vlerësuar saktësinë e pasqyrave financiare të subjektit); në auditimet e përputhshmërisë/ operacioneve (vlerësimi i kontrolleve të brendshme); në auditimet e performancës (përfshirë çështjet e sistemeve të informacionit); auditimet mjeko-ligjore dhe auditimet e projekteve zhvilluese të sistemeve të informacionit. Pavarësisht llojit të auditimit, audituesi i IT duhet të vlerësojë politikën dhe procedurat që udhëzojnë mjedisin e përgjithshëm të IT të subjektit të audituar duke siguruar se ekzistojnë kontrollet respektive dhe mekanizmat e zbatimit. Qëllimi i auditimit të IT do të përfshijë zgjedhjen e shtrirjes së shqyrtimit të auditimit, mbulimin e sistemeve të IT dhe funksioneve të tyre, proceset e IT që do të auditohen, vendndodhjet e sistemeve të IT që do të mbulohen si dhe periudha që do të shtrihet. Do të jetë, në fakt, vendosja ose tejkalimi i limiteve të auditimit.

Kontrollet e IT

Një kontroll është kombinimi i metodave, politikave dhe procedurave që sigurojnë mbrojtjen e aseteve të organizatës, saktësinë dhe besueshmërinë e regjistrimeve të tyre, si dhe përputhjes operacionale me standardet e menaxhimit. Në kontekstin e IT, kontrollet ndahen në dy kategori: të përgjithshëm dhe të aplikacioneve. Kategoria varet nga shtrirja e ndikimit dhe nëse është e lidhur me ndonjë aplikacion në veçanti. Kontrollet e përgjithshëm të IT janë baza e strukturës së kontrollit të IT. Ato kanë të bëjnë me mjedisin e përgjithshëm në të cilin sistemet e IT janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur. Kontrollet e përgjithshëm të IT vendosin një strukturë gjithëpërfshirëse për aktivitetet e IT dhe garantojnë siguri se do të arrihen objektivat e përgjithshëm të kontrollit. Kontrollet e përgjithshëm janë implementuar duke përdorur një sërë mjedesh siç janë politikën, udhëzimet dhe procedurat, si dhe duke vendosur një strukturë të dobishme menaxhimi, duke përfshirë edhe atë për menaxhimin e sistemeve të IT të organizatës. Shembuj të kontrolleve të përgjithshëm, përfshijnë zhvillimin dhe implementimin e Strategjisë IS dhe një Politikë Sigurie IS, ngritjen e komitetit të drejtimit të IT, organizimin e stafit të IT për ndarjen edetyrave konfliktuese dhe

planifikimin e parandalimit dhe rikuperimit të katastrofave. Kontrollat e aplikacioneve janë kontrolle specifike unike për çdo aplikacion të kompjuterizuar. Ato aplikohen në segmente aplikacionesh dhe merren me të dhënat e transferueshme dhe ato të qëndrueshme. Kontrollat aplikative përfshijnë vlefshmërinë e të futjes së të dhënave, kriptimi i të dhënave për tu transmetuar, kontrollet procesuese etj. Për shembull, në një aplikacion pagese online, një kontroll input mund të jetë data e skadencës së kartës së kreditit e cila duhet shtrihet përtej datës së transaksionit, dhe të dhënat e futura duhet të jenë të krijuara. Kontrollat e përgjithshme dhe aplikative të IT dhe marrëdhëniet e tyre Kontrollat e përgjithshme të IT nuk janë specifike ndaj niveleve të transaksioneve ose ndaj paketave të caktuara të kontabilitetit ose ndaj aplikacioneve financiare. Objektivi i kontrolleve të përgjithshme të IT është të sigurojnë zhvillimin dhe implementimin e duhur të aplikacioneve, ashtu si edhe të programeve, skedarëve të të dhënave dhe operacionet kompjuterike. Dizenjimi dhe implementimi i kontrolleve të përgjithshme të IT mund të kenë një ndikim mbi efektivitetin e kontrolleve aplikative. Kontrollat e përgjithshme pajisin aplikacionet me burimet e nevojshme për operim dhe sigurojnë se ndryshime të paautorizuara nuk mund të ndodhin as në aplikacione (për shembull, ato i mbrojnë nga riprogramimi) ose në bazat e të dhënave të lidhura me to (grumbullimi i madh i transaksioneve të të dhënave). Kontrollat më të zakonshme të përgjithshme të IT të cilat rrisin kontrollet e aplikacioneve janë:

-kontrollet e aksesit logjik mbi infrastrukturën, aplikacionet dhe të dhënat, -kontrollet e zhvillimit të ciklit të jetës së sistemit,

-kontrollet e programit të menaxhimit të ndryshimit, -kontrolli i aksesit fizik mbi qendrën e të dhënave, -kontrollet e backup-it dhe rikuperimit të sistemit dhe të të dhënave,

-kontrollet e operacioneve kompjuterike Kontrollat e aplikacioneve operojnë në transaksione individuale dhe sigurojnë se inputi, përpunimi dhe outputi kryhen në mënyrë të saktë.

Dizenjimi dhe efektiviteti i operimit të kontrolleve të përgjithshme të IT ndikojnë nivelin në të cilin kontrollet aplikative mund të mbështeten, që menaxhimi të kontrollojë risqet. (Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, 2011/2012)

2.7 Besushmëria e fakteve te auditimit

Dëshmia e auditimit është e nevojshme për të mbështetur opinionin dhe raportin e auditorit. Është kumulative në natyrën dhe është marrë kryesisht nga procedurat e auditimit të kryera gjatë rrjedhës së auditimit. Megjithatë, mund të përfshijë edhe informacionin e marrë nga burime të tjera të tilla si auditimet e mëparshme (me kusht që auditori ka përcaktuar nëse ndryshimet kanë ndodhur që nga ajo kohë auditimi i mëparshëm që mund të ndikojë në rëndësinë e tij në auditimin aktual ose cilësinë e një firme procedurat e kontrollit për pranimin dhe vazhdimin e klientit. Përveç burimeve të tjera brenda dhe jashtë njësisë ekonomike, të dhënat kontabël të njësisë ekonomike janë një burim i rëndësishëm i auditimit. Gjithashtu, mund të jenë përgatitur informatat që mund të përdoren si dëshmi auditimi duke përdorur punën e një eksperti të menaxhmentit. Dëshmia e auditimit përfshin të dyja informacionet që mbështet dhe vërteton pohimet e menaxhmentit dhe çdo informacion që bie në kundërshtim pohime të tilla. Përveç kësaj, në disa raste mungesa e informacionit (për shembull, refuzimi i menaxhmentit për të ofruar një përfaqësim të kërkuar) është përdorur nga auditori, dhe prandaj, gjithashtu përbën dëshmi të auditimit. Pjesa më e madhe e punës së auditorit në formimin e opinionit të auditorit konsiston në marrjen dhe vlerësimin e dëshmi të auditimit. Procedurat e auditimit për të marrë dëshmi të auditimit mund të përfshijnë inspektimin, vëzhgimin, konfirmimin, rillogaritjen, reperformimin dhe procedurat analitike, shpesh në disa kombinime, përveç hetimit. Megjithatë hetimi mund të sigurojë auditim të rëndësishëm prova, dhe madje mund të prodhojë dëshmi për një gabim, vetëm hetimi zakonisht kryen të mos ofrojë dëshmi të mjaftueshme të auditimit për mungesën e një gabimi material në nivelin e pohimeve, as efektivitetin e operimit të kontrolleve. Mjaftueshmëria dhe përshtatshmëria e evidencës së auditimit janë të ndërlidhura. Mjaftueshmëria është masën e sasisë së provave të auditimit. Sasia e evidencës së auditimit e nevojshme është e prekur nga vlerësimi i auditorit për rreziqet e gabimeve (sa më i lartë të jetë rreziku i vlerësuar, ka të ngjarë që të kërkohe më shumë dëshmi të auditimit) dhe gjithashtu nga cilësia e dëshmi të tilla të auditimit (sa më i lartë cilësia, aq më pak mund të kërkohe). Megjithatë, marrja e më shumë provave të auditimit, nuk mund të kompensojë cilësinë e tij të dobët.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Niveli makro i planifikimit të auditimit zakonisht kryhet në baza vjetore në nivel SAI për përzgjedhjen e fushave të auditimit. Me shtimin e shpejtë të sistemeve moderne IS në qeveri të ndryshme, dhe me kufizimin e burimeve të disponueshme ndaj SAI-ve, është e përshatshme një qasje e bazuar në risk për përcaktimin e përparësive dhe çështjeve të duhura. Për më tepër, SAI duhet gjithashtu të përfshijë këto auditime të detyrueshme, si ato të kërkuara me ligj ose të kërkuara nga parlamenti, kongresi ose subjekte mbikëqyrëse.

Qasje bazuar në risk zakonisht, SAI-t kanë në mandatin e tyre një numër organizatash që përdorin sistem të ndryshëm informacioni. Ekzistojnë aplikacione të ndryshme për funksione dhe aktivitete të ndryshme, ekzistojnë një numër i madh instalimesh kompjuterike në vendndodhje të ndryshme gjeografike. Ndërkohë që ka risqe të qenësishme ndaj sistemeve të informacionit, këto risqe prekin sisteme të ndryshme në mënyra të ndryshme. Risku i mosgatishmërisë qoftë edhe për një orë, mund të jetë shumë serioz për një sistem faturimi në një dyqan të madh shitjesh.

Tabela 3. Komponentët e riskut të biznesit dhe auditimit

Risku i biznesit	Risku i auditimit						
Risku që kompania do të dështojë në arritjen e objektivave të saj	Risku që audituesit mund të japin një opinion të papërshtatshëm.						
Shembuj objektivash: Arritja e një niveli të caktuar përfitueshmërie; maksimizimi i pasurisë së akcionerëve; sigurimi i frytshmërisë dhe efektivitetit të operacioneve; zënia e një pjesë të caktuar tregu; kënaqësia e klientit; mbajtja e një niveli të kënaqshëm likuiditeti; ruajtja e reputacionit.	Risku i angazhimit	Risku i brendshëm		Risku i kontrollit	Risku i identifikimit		Risku i pavarësisë
	Risku që procesi i tenderimit ka detyruar audituesit të pranojnë një komision të ulët të palogjikshëm, duke kufizuar kohën e mjaftueshme për të kryer një auditim efektiv (cilësia e auditimit) dhe rritjen e presionit mbi pavarësinë. Një risk angazhimi është që audituesi mund të pranojë klientë që e kanë riskun e brendshëm tepër të lartë.	Risku i entitetit	Niveli i transaksioneve dhe balancave të llogarive	Faktorët që rrisin riskun e kontrollit: gabime njerëzore; lënia pas dore e kontrollit të brendshëm.	Risku i përzgjedhjes së kampionit	Risku i kontrollit të cilësisë	Risku që rrjedh edhe pse procedurat e auditimit kanë identifikuar keqraportim e që ndikojnë në vërtetësinë dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare. Audituesi mund të mos t'a raportojë atë si rrjedhojë e mungesës së pavarësisë.
	Shembuj: Integriteti i Drejtimit; kompetenca dhe eksperiencia e Drejtimit; presion i pazakontë mbi Drejtimin; natyra e entitetit të biznesit; natyra e industrisë; sistem kompjuterik kompleks.	Shembuj: transaksione jo subjekt i një procesi normal; kryerja e transaksioneve të pazakonta dhe komplekse; cilësia e sistemit kontabël.		Ky risk ekziston kur kampioni i përzgjedhur nuk është përfaqësues për popullatën dhe rezultatet keqinterpretohen – risku i gjykimit.	Audituesi dështon në mbledhjen e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për të vlerësuar saktë.		

Burimi: Gray et.al 2005

Risku i ndryshimeve të paautorizuara, mund të jetë burim mashtrimesh dhe humbesh të mundshme në një sistem online banke. Një sistem i përpunimit të grupeve, ose një sistem i bashkimit të të dhënave mund të jetë relativisht më pak riskoz në krahasim me risqe të tjerë. Mjediset teknike në të cilat janë të vendosura sistemet, gjithashtu mund të ndikojnë risqet që janë të lidhura me sistemet. Një qasje e bazuar në risk në përzgjedhjen e sistemeve të IT për auditimi, ndihmon audituesit në përcaktimin e prioriteteve të auditimit. Për përdorimin e strukturës së vlerësimit të riskut, një SAI duhet të ketë informacione mbi agjencitë, zakonisht të grumbulluara nëpërmjet sondazheve.

Hapat në qasjen e bazuar në risk

1. Identifikoni universin e auditimit, i cili do të përbëhet nga një listë e të gjitha organizatave të auditueshme ose të njëjësive nën juridiksionin e SAI;
2. Listoni sistemet e informacionit në përdorim në njësitë/organizatat që do të auditohen;
3. Identifikoni faktorët të cilët prekin gjendjen kritike të sistemit në një organizatë për realizimin e funksioneve të saj dhe ofrimin e shërbimit;
4. Përcaktoni peshën ndaj secilit faktor, gjë e cila mund të kryhet në bashkëpunim me organizatën nën auditim;
5. Përpiloni informacionin për të gjithë sistemet, nëpër të gjitha organizatat, dhe bazuar në përfundimet e grumbulluara, vendosni sistemet/organizatat sipas prioritetit për auditim;
6. Përgatitni një plan vjetor auditimi i cili duhet të theksojë prioritetin, qasjen dhe programin e auditimit IT. Ky veprim mund të kryhet në intervale vjetore dhe në këtë mënyrë mund të jetë një plan i përsëritur.

Ndërkohë që një proces i vlerësimit të riskut është një mënyrë për përzgjedhjen e subjektit për auditim IT, SAI gjithashtu përzgjedh subjektet në baza ciklike, duke shfrytëzuar mandatin, ose sipas kërkesës së organeve mbikëqyrëse (Kongres, Parlament etj.).

Planifikimi Mikro (ose në nivel subjekti)

Planifikimi mikro përfshin zhvillimin e planeve të detajuara të auditimit për subjektin e përzgjedhur duke filluar nga theksimi i objektivave të auditimit. Plani i auditimit do të ndihmojë audituesit në përgatitjen e programit të auditimit IT. Hapi i domosdoshëm në zhvillimin e programit të auditimit, do të jetë njohja e subjektit dhe sistemeve të tij të informacionit. Ky Manual do të ndihmojë audituesit pasi plani është hartuar në popullimin e matricës së auditimit me objektiva specifike auditimi për çdo fushë (qeverisje, siguria e informacionit etj) që do të inspektohet. Planifikimi në nivel mikro kërkon njohjen e subjektit dhe disa vlerësime paraprake të kontroleve për lehtësimin e planifikimit të detajuar të auditimit.

4. METODOLOGJIA

Niveli i njohurisë mbi organizatën dhe proceseve të saj, të kërkuara nga audituesit e IT do të përcaktohen nga natyra e organizatës dhe nivelit të detajeve të punës audituese që është duke u kryer. Njohja e subjektit duhet të përfshijë risqet e biznesit, financiarë dhe ata të brendshëm, me të cilët përballet organizata dhe sistemet e saj të IT. Duhet gjithashtu të përfshijë masën që shpreh varësinë e organizatës nga blerja e zgjidhjeve teknologjike nga tregtarët për arritjen e objektivave të saj dhe sesi janë pozicionuar proceset e plota të biznesit në mjedisin e IT. Audituesi duhet të përdorë këtë informacion në identifikimin e problemeve të mundshme, në formulimin e objektivave dhe të qëllimi të punës, në kryerjen e punës dhe në marrjen parasysh të veprimeve të menaxhimit për të cilët audituesi duhet të jetë vigjilent. Materialiteti i një çështje të auditimit të IT duhet të përcaktohet nën një kuadër të përgjithshëm për vendosjen e politikave të materialitetit në një SAI. Në formulimin e raportit të auditimit, audituesi duhet të konsiderojë materialitetin në përmbajtje të pasqyrave financiare (auditim rregullshmërie) ose në natyrën e subjektit/aktivitetit. Audituesi i Sistemeve të Informacionit duhet të përcaktojë nëse ndonjë mangësi e IT mund të shndërrohet në material. Rëndësia e këtij kontrolli të mangët të IT duhet të vlerësohet në lidhje me ndikimin e kontrolleve aplikativë, për shembull, nëse kontrollet aplikativë të ndërlidhur me të janë gjithashtu të prekur. Nëse mangësia në aplikacion është e shkaktuar nga kontrolli i përgjithshëm i IT, atëherë ato janë material. Për shembull, nëse një llogaritje takse e bazuar mbi një aplikacion është gabim material dhe është shkaktuar nga një kontroll i dobët ndryshimi në tabelat e taksës, atëherë vendimi i menaxhimit për mos-rregullimin e mangësive në kontrollet e përgjithshëm të IT dhe lidhja e tij me mjedisin kontrollues, mund të shndërrohen në materiale kur ato bashkohen me mangësi të tjera që prekin mjedisin kontrollues.

Auditimi i IT kërkon shpërndarje specifike të burimeve, sidomos forcën punëtore, e cila duhet të jetë e pajisur me njohuri të mira të sistemeve tipikë të IT, proceseve dhe mekanizmave të cilat udhëheqin një implemtim të suksesshëm të IT. Përveç burimeve njerëzore të përshtatshme, buxhetit të mjaftueshëm, infrastrukturës, çdo nevojë tjetër e identifikuar duhet të garantohet. Kohështrirja e auditimit duhet të përcaktohet, nëse është e mundur, duke u këshilluar me subjektin e audituar. Angazhimi me subjektin nën auditim

duhet të jetë i informuar rreth qëllimit, objektivave dhe kriteret e vlerësimit të auditimit duhet të diskutohen me ta sipas nevojës.SAI mundet, nëse është e nevojshme, të hartojë një dokument angazhimi për subjektin nën auditim, ku të cilësojë gjithashtu edhe termat e angazhimit.SAI duhet të sigurojë se nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbështetjes së subjektit nën auditim, të përmbyllë auditimin, duke përfshirë aksesin ndaj regjistrimeve dhe informacionit, manual ose elektronik qoftë.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Audituesi i IT duhet të ndërmarrë një vlerësim paraprak të kontrolleve të IT në sistemin që po auditohet për të nxjerrë një kuptim të sigurisë se kontrollet ekzistuese (Kontrollet e përgjithshëm dhe ata të aplikacioneve) janë të besueshme. Vlerësimi i kontrolleve në këtë nivel do të përfshijë:

- a. Vlerësimi se mekanizma të përshtatshëm të Qeverisjes së IT ekzistojnë dhe janë funksionalë.
- b. Vlerësimi se objektivat e IT janë paralel me objektivat e biznesit.
- c. Vlerësimi se mekanizmat e duhet të ekzistojnë për blerjen e zgjidhjeve IT (ku përfshihen aplikacionet IT, hardware, software, burimet njerëzore, rrjeti, shërbime etj).
- d. Kontrollet në nivel organizacional të përfshira në operacionet e IT që udhëheqin çdo ditë funksionet e IT, procedurat e sigurisë së informacionit të organizatës, vazhdimësinë e biznesit dhe procedurat e backup-it, menaxhimin e ndryshimit, ofrimin e shërbimit dhe feedback.

Elementët e mësipërm, përfshijnë kontrollet e përgjithshëm të IT të cilët nuk janë specifike ndaj çdo transaksioni të veçantë ose aplikacioni, por kanë lidhje me infrastrukturën e përgjithshme të IT në organizatë, përfshirë këtu politikat e IT, procedurat dhe praktikat e punës. Testimet duhet të jenë veçanërisht të dizenuara duke përdorur teknika përfshirë intervista, sondazhe me pyetësorë, observime, kontrolle fizik, vështrimi i të dhënave dhe analizimi i tyre etj.

Në testimet e pavarura, testet janë dizenuar të vërtetojnë pohimet sipas objektivave të auditimit. Testimet e pavarura përfshijnë teste të detajuara të kontrolleve të IT që përdorin teknika dhe mjete të ndryshme për hetimin, nxjerrjen dhe analizimin e të dhënave. Analizimi i të dhënave përfshin elementët e listuar më poshtë:

- Identifikoni qëllimin e analizës ose projektit;
 - Njihni kampionët nën studim;
- Njihni paraqitjen dhe formatin e të dhënave;
- Vendosni një identifikues të vetëm nëse ka dublikime ose bashkime;
 - Deklaroni objektivat e pyetjeve të kërkimit/të auditimit

- Metodat e përdorura për përgjigjen e pyetjeve të kërkimit
- o Kriteret e vlerësimit
- o Evidencat
- o Analizat
- o Konkluzionet
- Procedurat e ristrukturimit të dosjeve (krijimi i sintaksës, shtimi i parametrave të tjerë sipas nevojës);
- Procedurat e pastrimit të të dhënave (për shembull heqja e kufijve)

Analizat më të shumta mund të ekzekutohen direkt në një dosje pune. Disa analiza mund të kërkojnë modifikime të të dhënave të papërpunuara, grupime, ose futje të të dhënave specifike për tu përshtatur me programet statistikore. Sistemet e IT përdorin shumëllojshmëri të dhënash dhe formatesh (numerike, karaktere, alfa, etj). Audituesi i IT duhet të ketë njohuri të këtyre formateve dhe të përdorë mjetet e duhura në analizimin e të dhënave. Audituesi mund të përdorë Program të Përgjithshëm Auditimi ose Program Specifik Auditimi për të kryer analizimin e informacionit. Mjete si Microsoft Excel, Microsoft Access, IDEA, ACL etj. Janë shembuj të programeve të përgjithshëm auditimi të cilët ofrojnë lehtësira në importimin dhe analizimin e të dhënave. Pas kësaj secila prej teknikave të mëposhtme, sipas kërkesave mund të adoptohet nga audituesit e IT si:

a) Nxjerrjen e të dhënave duke kopjuar të dhënat nga subjekti. Audituesi i IT mund të duhet të krijojë një mjedis të ngjashëm (sistem operativ, sistem i menaxhimit të bazës së të dhënave, hardware etj), si të subjektit nën auditim për të analizuar/nxjerrë të dhëna nga kopja e të dhënave. Audituesi i IT mundet gjithashtu të ketë nevojë të konvertojë të dhënat nga një lloj në tjetrin për të lehtësuar leximin dhe analizimin e tyre.

b) Shfrytëzimi i programeve të auditimit për nxjerrjen e të dhënave nga kombinime të ndryshme të sistemeve të operimit, sistemeve të menaxhimit të bazës së të dhënave, sistemeve aplikative etj. Audituesit e IT mund të përdorin Programe të Përgjithshëm Auditimi ose Programe Specifikë Auditimi. Programet e përgjithshëm të auditimit mund gjithashtu të jenë për industri të veçanta ose mund të jenë programe shfrytëzues, të cilët mund të përdoren për të vlerësuar funksionimin e shërbimeve të ndryshme të sistemeve

kompjuterikë. Përdorimi i secilit prej tyre, ose kombinimit të tyre është në varësi të objektivave dhe qëllimit të auditimit që do të trajtohet në Auditimin e IT.

c) Kryerja e testimit të të dhënave në situatat ku cilësia e programit është si synim për tu testuar. Premisat tregojnë që është e mundur të përgjithësojmë mbi besueshmërinë në total të një programi nëse është i besueshëm për një grup testimesh specifikë. Përdorimi i të dhënave të testimit përfshin Dizenjimin e të dhënave të testimit dhe Krijimin e të dhënave të testimit përpara se të ekzekutojmë programin me të dhënat e testimit. Audituesi i IT duhet të zgjedhë vlerësimin e saktë të riskut dhe të përdorë teknika kampionimi për të konkluduar në përfundime të përshtatshme bazuar në kontrolle të mjaftueshme statistikore mbi të dhënat e limituara. Përgjithësisht është një praktikë e mirë ndihma nga ekspertë brenda organizatës për përzgjedhjen dhe përcaktimin e kampionëve.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sipas rishikimit të literaturës dhe standarteve

1. Auditimi i Brendshëm është një funksion i domosdoshëm për çdo bankë për t'i dhënë një siguri të arsyeshme Komitetit të Auditimit dhe Bordit Drejtues mbi mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, mjaftueshmërisë në punën e kryer për biznesin, drejtimit të riskut brenda bankës dhe qeverisjes së bankës.

2. Auditimi i Brendshëm vlerëson mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës dhe mbulimin e risqeve kryesore të saj (të kredisë, tregut dhe operacional), duke ndikuar në shëndetin financiar të bankës dhe stabilitetit të sistemit financiar në tërësi.

3. Funksioni i Auditimit të Brendshëm luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e përputhshmërisë së aktiviteteve të bankës me ligjet dhe rregulloret e vendosura nga autoritetet shtetërore duke siguruar që mos të ketë shmangie nga kuadri ligjor dhe duke eliminuar penalizime që do dëmtonin reputacionin e bankës.

4. Ekziston një diferencë e qartë mes Auditimit të Brendshëm dhe Kontrollit të Brendshëm, pavarësisht se të dy konceptet shpesh nga palë të tjera brenda bankës apo jashtë saj, përzihen ose shkrihen në një të vetëm duke i atribuar Auditimit të Brendshëm dhe përgjegjësi që nuk i takojnë. Kontrolli i brendshëm përfshin politikat, procedurat, praktikat dhe strukturat të cilat sigurojnë që objektivat e biznesit do të arrihen dhe ngjarjet e padëshiruara të riskut do të parandalohen ose identifikohen dhe korrigjohen, ndërsa funksioni i Auditimit të Brendshëm duhet të vlerësojë në mënyrë të pavarur efikasitetin dhe mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe proceseve të krijuara nga njësitë e biznesit, si dhe të funksioneve mbështetëse duke garantuar këto sisteme dhe procese. Në mënyrë që një bankë të ketë një sistem kontrolli të brendshëm efikas duhet që secila nga tre linjat e mbrojtjes të funksionojë duke mos deleguar të gjitha përgjegjësitë tek Auditimi i Brendshëm si linja fundore.

5. Auditimi i Brendshëm dhe ai i Jashtëm janë dy aktivitete të ndryshme, nuk dublojnë njëri – tjetrin. Auditimi i Jashtëm është ndërtuar për t'u dhënë siguri Aksionerëve dhe Publikut të gjerë. Ai është kryesisht i fokusuar në pasqyrat financiare, në vërtetësinë e informacionit dhe situatën reale financiare, ndërsa Auditimi i Brendshëm ka një fokus gjithëpërfshirës brenda bankës.

6. Të gjitha standartet ndërkombëtare mbi Auditimin e Jashtëm dhe të Brendshëm theksojnë se audituesit duhet të kenë njohuri të mjaftueshme që të vlerësojnë riskun e mashtrimit dhe mënyrën se si ai drejtohet, por nuk pritet që të kenë ekspertizën e dikujt përgjegjësia parësore e të cilit është identifikimi dhe investigimi i mashtrimit.
7. Procesi i auditimit shoqërohet nga një risk i pashmangshëm që njihet si risku i auditimit, çka mund të bëjë që procesi i Auditimit të Brendshëm dhe të dështojë në ndonjë rast.

7. REFERENCAT

- Çfarë është Qeverisja e IT dhe Pse është e rëndësishme për audituesin e IS, WGITA, IntoIT.
- Struktura COBIT 4.1, (2007), Institucioni i Qeverisjes së IT.
- Struktura COBIT 5, (2012), Isaca
- Brisebois, R., Boyd, G. and Shadid, Z. (n.d.). *What is IT Governance? and why is it important for the IS auditor.* [online] Intosaiitaudit.org. Available at: http://www.intosaiitaudit.org/intoit_articles/25_p30top35.pdf
- ISO/IEC 38500, Qeverisja e Korporatës mbi Teknologjinë e Informacionit
- OECD Parimet e Qeverisjes së Korporatës, OECD 1999 dhe 2004
- Michaels Paul; Anand, Navin; Iyer; Sudha; Çfarë është Qeverisja e IT. Bota Kompjuterike, UK, Prill (2012).
- Gao.gov. (2004). *INFORMATION TECHNOLOGY INVESTMENT MANAGEMENT. A Framework for Assessing and Improving Process Maturity.* [online] Available at: <https://www.gao.gov/new.items/d04394g.pdf>
- Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm”, (2013) Kosovë;
- Doracaku i auditimit të brendshëm në Kosovë;
- Standardet e auditimit të brendshëm; Kodi i etikës;

- Moduli “Bazat e auditimit të brendshëm” botuar në vitin 2011/2012, Shqipëri;
- Materialet nga trajnimet dhe seminarët e ndryshme.